



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë. 04.06.2013
Nr. 0204 - 681

PËR Ramadan Muja, Kryetari i Komunës së Prizrenit
Nijazi Kryeziu, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Prizrenit

LËNDA: KËRKESË PËR RISHQYRTIM E LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT, NR. 01/011 - 5962

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011 - 5962, të datës 26.04.2012, lidhur me dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të pronës komunale Teqesë së Madhe- Tarikati "Saadi", **KONSTATON** se:

- Vendimi nr. 01/011-5962, të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, është në kundërshtim me nenin 5 dhe 6 të Ligjit nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, ku duhet të përcaktuar afati për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale;
- Kuvendi i Komunës nuk ka të drejtë të jep pronën komunale në shfrytëzim derisa lidhur me pronën në fjalë është i hapur kontesti gjyqësor.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 82 pika 2 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale *kërkon* nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës së Prizrenit që të ndër marrin veprime konkrete që, Vendimi nr. 01/011-5962 i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të pronës komunale për rindërtimin e Teqesë së Madhe -Tarikati "Saadi, të harmonizohet me dispozitat ligjore të Ligjit nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: *Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Drejtoreve të Departamenteve dhe Drejtoreve të Zyrave
Arkivit të MAPL-së.*



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum. 04.06.2013
br. 0204 - 681

Za Ramadan Muja, Gradonačelnik opštine Prizren
Nijazi Kryeziu, Predsedavajući Skupštine opštine Prizren

Predmet: Zahtev za ponovno razmatranje zakonitosti odluke opštine Prizren , br. 01/011 - 5962

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja zakonitosti odluke Skupštine opštine Prizren br. 01/011 - 5962, dana 26.04.2012, o davanju na privremeno korišćenje opštinsko zemljišta Teqesë së Madhe- Tarikati "Saadi", **KONSTUJE:**

- Odluka br. 01/011-5962, Skupštine opštine Prizren , je u suprotnosti sa članom 5 i 6 zakona br. 04/z-144 o davanju na koristi i razmeni nepokretnog opštinskog zemljišta, gde se treba odrediti rok za davanje na koristi nepokretnog opštinskog zemljišta.
- Skupština opština nema pravo da daje opštinsku imovinu na koristi dok je na navedenoj imovini otvorena parnica .

Ministarstvo administracije lokalne samouprave , na osnovu člana 82 tačka 2 zakona o lokalnoj samoupravi *zahteva od strane Skupštine opštine /Gradonačelnik opštine Prizren da preduzme konkretne mere da se odluka br. 01/011-5962 Skupštine opštine Prizren , o davanju na privremenoj koristi opštinsko zemljište za rekonstrukciju Teqesë së Madhe -Tarikati "Saadi, uskladi sa zakonskim odredbama zakona br. 04/z-144 za davanje na koristi i razmeni nepokretne opštiinske imovine , u roku od 30 dana od dana prijema zahteva na ponpveno razmatranje.*

Sa poštovanjem,
Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopije: *Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Direktorima odeljenja i kancelarija
Arhivi MALS-a.*

Në bazë të nenit 6 dhe nenit 7. të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2 pika c, nenit 14, alineja 1 dhe nenit 40, alineja 3, të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 27 alineja 1, të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e vetë të mbajtur me 26 prill 2013, morri këtë:

V E N D I M

M B I D H Ë N I E N N Ë S H F R Y T Ë Z I M T Ë P Ë R K O H S H Ë M T Ë P R O N Ë S K O M U N A L E

Neni 1

Aprovohet kërkesa e Teqesë së Madhe-Tarikati "Saadi"- ish pronar për dhënie e Pronës Komunale në Shfrytëzim, ashtu që lejohet dhënia në shfrytëzim e ngastrës kadastrale nr.01882-0 ZK-Prizren.

Neni 2

Ngastra kadastrale nr. 01882-0, ZK-Prizren, në vendin e ashtu quajtur „VLLAZNIM BASHKIM, që evidentohet sipas Certifikatës nr. 18-7813, të datës 13.05.2013, (si shtëpi-nuk ekziston-shembur në sipërfaqe prej 393m/2 dhe oborr në sipërfaqe prej 204m/2) respektivisht në sipërfaqe të përgjithshme prej 597m², e cila e evidentohet si pasuri shoqërore KK-Prizren.

Neni 3

Prona në fjalë e përshkruar si në nenin 1 dhe 2, të këtij vendimi jepet në shfrytëzim ish pronarit- Teqesë së Madhe-Tarikati "Saadi", me qëllim të rindërtimit të Teqes në formën dhe vendin ku ka qenë deri në rrënimin e dhunshëm, nga ish regjimi komunist në përputhje të plotë, me Planin që do të lejohet nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore-Historike në Prizren.

Neni 4

Afati Kohor për dhënie në shfrytëzim të pronës Komunale, do të jetë gjer në zgjidhjen e kontestit gjyqësor rreth kësaj prone, në rast të vendimit negativ për pronarin, objekti bashke me token ndërtimore do të kalojë në pronësi të komunës.

Neni 5

Me Rindërtimin e Objektivit të Teqes, Komuna e Prizrenit, do të kontribuoj në rindërtimin e Teqesë, në themelet e Teqes së vjetër, që ka qenë objekt me vlerë kulturo-historik dhe në bazë të pëlqimit paraprak të dhënë nga ish pronarët-shfrytëzuesit do ta lënë në shfrytëzim në kohë të pacaktuar të njëjtën në rast nevojës të Komunë apo organeve qeveritare.

Neni 6

AUTORIZOHET Kryetari i Komunës të nënshkruaj kontratën përkatëse për dhënie në shfrytëzim për qëllime dhe nën kushte të cekura më lartë.


Neni 7

Me këtë vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Sektori i Çështjeve Pronësore Juridike dhe Avokati Publik Komunal.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës së Prizrenit dhe do të shpallet në "Kumtar".

KOMUNA E PRIZRENIT
Kuvendi i Komunës
Nr: 01/011-5962
Më:21 tetor 2011
Prizren



Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu